



**Prishtinë, 02 maj 2013**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_534\_2013**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, Nenit 25, Nenin 29 dhe Nenit 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 34 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201);
- Dispozitat e Nenit 15 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 03/L-184);
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (Ligji Nr.02/L-123) dhe
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 6 dhe Nenit 18 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Importit dhe Eksportit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në ZRRE me datë 07.02.2013 nga ndërmarrja “MCM COMMODITIES” SH.P.K adresa: Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

**në seancën e mbajtur me datë 02 maj 2013, nxori këtë:**

## **VENDIM**

**I. I LËSHOHET** Licenca për import dhe eksport të energjisë elektrike ndërmarrjes “MCM COMMODITIES” SH.P.K, me numër licence ZRRE/Li\_40/13 për periudhën nga data **02 maj 2013 deri 02 maj 2018.**

## **Arsyetim**

- Ndërmarrja “MCM COMMODITIES” SH.P.K me datë 07.02.2013 ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për Licencim të aktivitetit për import dhe eksport të energjisë elektrike nga
  - ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të ZRRE-së dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit për import dhe eksport të energjisë elektrike.
  - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Licenca për import dhe eksport të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë me kapacitet deri 100 MW, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.



III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar